

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"INOX - STYLE " SHPK**

Sot, më datë 04/04/2022, u paraqiten personalisht:

- **Z. Gëzim Çuni**, i datëlindjes 14/07/1971, shtetas shqiptar, lindur ne Lezhë dhe banues ne Lezhë. Person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me Nr. Personal H10714175N.

I cili përpiloi këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **"INOX - STYLE"** SH.P.K, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

**Forma Ligjore**

Të themeloj Shoqërinë Tregtare **" INOX - STYLE "** SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **"INOX-STYLE"** SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2**

**Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit **" INOX - STYLE "** SH.P.K dhe me emrin tregtar **INOX - STYLE** . Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Prodhim, përpunim, tregtim dhe montimi i strukturave te inoksit.

**NENI 5**

**Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Lezhë, në adresën: **Ndertese Superstrada Lezhë-Shëngjin, Lagjia Sakë, Nr. Pas 49/11, zk 1987, Shëngjin, Lezhë.**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

## **NENI 6**

### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar është Lekë 100.000 (Njeqind mije leke) dhe zotërohet nga ortakët themelues:

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: Lekë 100.000 (Njeqind mije leke)

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortakët themelues.

## **NENI 7**

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare " **INOX - STYLE** " SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortakët themelues :	<b>Gëzim Çuni</b>
Numri i kuotave :	<b>1</b>
Numri i pjeseve :	<b>1</b>
Pjesëmarrja në Shoqëri :	<b>100,00 %</b>
Lloji i kontributit:	<b>Ne para</b>
Vlera e kontributit	<b>100,000 ( Njeqind mije) leke</b>

Duke qenë se Kapitali themeltar do të depozitohet në llogarinë e Shoqërisë e cila do të hapet pas regjistrimit në QKB, atëherë ortakët vendos që kjo shume do të paguhet prej tij jo më vonë 3 muaj nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, në llogarinë e shoqërisë tregtare. Rregullat e pagesës së kësaj shume janë parashikuar në këtë Statut.

## **NENI 8**

### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## **NENI 9**

### **Administratori/ët**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërisë do të jetë :

- Z. **Gëzim Çuni**, i datëlindjes 14/07/1971, shtetas shqiptar, lindur ne Lezhë dhe banues ne Lezhë. Person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me Nr. Personal H10714175N.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 10**

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

#### **NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues, u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaku eshte njohes i gjuhes shqipe.

### **ORTAKET THEMELUES**

**Gëzim Çuni**

